

R E P U B L I K A E K O S O V Ë S
/REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO/
GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE / OSNOVNI SUD U MITROVICI / BASIC COURT OF MITROVICA

C.nr. 150/2008

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE, Gjyqtari Ragip Kadriu ne qeshtjen juridike te paditesit; [] nga Fsh. [] Komuna e [] te cilin e perfaqson Avokat; [] nga Mitrovica sipas autorizimit me shkrim, kunder te paditurit; [] nga Mitrovica, tani me vendbanim te panjohur te cilin e perfaqson, Perfaqsuasi i perkohshem Avokat; [] nga Mitrovica sipas aktvendimit te kesaje gjykate, baza e kontestit; Vertetim pronesie, vlera e kontestit; 1.000,00 Euro, pase mbajtjes se shqyrtimit kryesor te dt.29.04.2014 jep kete;

A K T G J Y K I M

I-APROVOHET kerkespadia e paditesit; [] nga Fsh. [] Komuna e [] dhe **VERTETOHET** se i njejti ne baze te shitblerjes se bere me dt. 31.07.2002 eshet pronar i palujtshmerise pjeses se parc.katastrale 235/1 me kultur are e klases se 3 ne vendin e qujtur " [] " ne sipërfaqe prej S= 477m2 me masa dhe kufi qe jan shenuar ne skicen e terrenit te ekspertizes [] e cila evidentohet ne emer [] ,ZK.

II- DETYROHET i padituri qe ti njoh kete te drejte paditesit dhe te lejoje qe paditesi kete palujtshmeri ta regjistroje ne emer te tije prane Drejtorise per Kataster dhe Gjeodezi ne Mitrovica, ne afatin prej 15 diteve, nga dita e pranimit te ketije aktgjykimi.

Secila pale i barte shpenzimet e veta te proedures kontestimore

A r s y e t i m

Paditesi ne padin e parashtruar si dhe nepermjet te autorizuarit te tije ne seancat e mbajtura ka theksuar se kete palujtshmeri nga i padituri diku ne vit 1980 kishte blere dhe kishte jetuar ne te deri ne kohen e luftes kur kjo shtepi eshte djegur dhe ne vit. 2001, paditesi kete shtepi e ka bler nga shitsi [] me qrast kan hartuar nje kontrat me shkrim por kjo palujtshmeri ende evidentohet ne emer te paditurit.

Pasi qe i padituri eshte ne adrese te panjohur i propozoj gjykates qe te njejtit ti caktoj perfaqsesin e perkohshem.

I autorizuari i paditesit ne seancen e shqyrtimit kryesore ne fjalen perfundimtare i propozoi gjykates qe padine dhe precizimin e kerkespadise ta aprovoi si te bazuar.

Shpenzimet e procedures kontestimore nuk i kerkoj

Ne baze te propozimit te autorizuarit te paditesit e konform nen 79.1.3/a dhe 81.1 te LPK, gjykata me aktvendimin C. nr.150/2008 dt. 24.09.2013 te paditurit i caktoj Perfaqsesin e perkohshem, Avokat nga Mitrovica i cili ne baze te ketije aktvendimi do ti ushtron te drejtat dhe detyrimet, konform nen. 82.1.2 te LPK.

Perfaqsesi i perkohshem i te paditurit ne pergjigje te padise dhe kerkespadise se paditesit propozoi qe gjykata te sjell aktgjykim ne baze te provave te administruara.

Shpenzimet e perocedures kontestmore nuk i kerkoj.

Gjykata ne seancen e shqyrtimit kryesore zhvilloi provat e propozuara dhe te nevojshme dhe pase administrimit dhe vlersimit te te njejtave ne kuptim te nen. 8 te LPK, erdhi ne perfundim se duhet vendosur si ne dispozitiv te keti aktgjykimi.

Gjykata ne proceduren e provave lexoi; Certifikaten e pronesis 12-7951 dt. 01.04.2014, Kontraten mbi shitblerjen e palujtshmerise dt. 31.07.2002,, Ekspertizen e ekspertit gjeodet Idriz Beqiri, dt 06.03.2014, Procesverbalin mbi kqyrje ne vend dt.21.02.2014, kopjen e planit dhe skicen e terenit dt.06.03.2014, Faturat e KEK-ut , dt 19.12.2013 dhe 19.02.2014, ndegjoi deshmitaret; dhe dhe konstatoi kete gjendje faktike.

Nga Certifikata e pronesis e sipercekur, vertetohet se palujtsheria tani lendore evidentohet ne emer te paditurit.

Nga Kontrat mbi shitblerjen e patundshmerise dt 31.07.2002 eshte cekur se paditesi nga shitesi Islam Nimani nga Prishtina ka blere shtepin me siperfaqe 200m2 dhe oborrin prej 5 ari me qmim te shitblerjes prej 100.000 DM,

Nga ekspertiza gjeodete e sipercekur , konstatohet se ne baze te dokumentacionit me te cilin posedon per momentin Drejtoria per Gjeodezi Kataster dhe Prone ne Mitrovice , eshte vertetuar se palujtshmeria kontestuese, bie gjegjesisht e perbene pjesa e parc. e cekur me larte me masa dhe kufi te shenuar si ne ekspertizen e dhene me shkrim dhe skicen e terenit e cila eshte pjese perberse e kesaje ekspertize dhe e aprovuar si ne dispozitiv te ketije aktgjykimi.

Nga skica e terenit dhe kopja e planit shifet shtrirja perkufizimi dhe siperfaqja e palujtshmerise tani lendore.

Nga Proqsverballi mbi kqyrje ne vend, gjyqtari me vrojtim te drejtperdrejt ne vend konstaton se ne kete palujtshmeri gjendet shtepia 1-katshe e banuar dhe se kjo palujtshmeri eshte e perkufizuar fizikisht.

Deshmitari deklaroi, une e di mire faktin kur Ukshini nga shitsi Islam Nimani diku ne vit 2001 ka bler afro 5 ari truall ne te cilen ka qene edhe shtepia e djegur. Qmimi ka qene 100.000 Dm e qe 50.000DM ia ka paguar ne dore me rastin e shitblerjes, ndersa shumen tjeter pas nje kohe ku une vete ia kam derguar shitesit ne Prishtine. Une kame qene prezent kur eshte bere shitblerja dhe kur i jane dhene thollat. Kjo palujtshmeri ka qen prone e shutesit te cilen e ka bler nga nje Serb qysh ne vit. 80. Ktu ka jetuar me familje gjere ne fillimin e luftes me qrast shtepia i eshte djegur. Sa kam njohuri ne kete qeshnje nuk ka asgje kontestuese. Shume here ka qene ne kete shtepi e cila ka qene prone faktike e tezes, gjegjesisht bashkshortit te saje Islamit.

Deshmitari deklaroi, une kame njohuri ka qen viti 2001-02 kur nga ka bler palujtshmerin, diku rreth 5 ari ku ka qene edhe shtepia e djegur. Qmimi ka qene 100.000 DM dhe ne tersi eshte paguar qmimi i shitblerjes. I njeiti per momentin jeton e ate shtepi dhe se nuk ka pasur kurfar pengese apo mosmarrveshje nga askush,

Nga faturat e KEK-ut vertetohet se [] eshet i ngarkuar si shfrytzues i sherbineve te KEK-ut

Nga provat e sipercekura me pamedyshje argumentohet fakti se i padituri palujtshmerin tani lendore e ka bler nga shitesi Islam Nimani sipas kontrates me shkrim mbi shitblerjen e palujtshmerise me qmim prej 100.000DM te cilin qmim e ka paguar ne tersi, dhe menjeher ka hy ne shfrytzim dhe disponim te lire te kesaj palujtshmerie.

Shitesi Islam Nimani kete palujtshmeri e ka bler nga i padituri qysh ne vit e 80, i cili ka jetuar me familje gjer ne Luften e Kosoves, me qrast i eshte djegur shtepia.

Ne nje gjendje te ketille faktike te cekur me larte, gjykata crdhi ne perfundim dhe konstatoi se palujtshmerin tani lendore e ka bler paditesi nga shitesi - si pronar faktik i saje. Kjo shitblerje eshte bere sipase Kontrates me shkrim mbi shitblerjen e palujtshmerise te sipercekur te cilin qmim ne tersi blesi tani paditesi ia ka paguar shitesit- i cili i ka lene ne disponim dhe shfrytzim te lire kete palujtshmeri paditesit te cilen e ka shfrytzuar pa kurfar pengese.

Nga kjo rrjedhe se kjo Kontrata e lidhur me shkrim e pavertetuar ne mes te paditesit ne cilsit te blesit dhe pronarit faktik ne cilsit te shitesit ne kuptim te nen 58 te Ligjit per marrdhenjet e detyrimeve [Ligji Nr, 04/L-077], eshte e vlefshme nga se e njejta eshte perbushur ne tersi nga palet kontraktuese.

Prandaj gjykata konkludon se ne rastin konkret kemi te bejme me fitimin e pronesise nga ana e paditesit ne baze te Kontrates mbi blerjen e palujtshmerise, konform dispozites ligjore te sipercekur.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës kontestimore, bazohet në bazë të nen.
450 të LPK.

Nga si u tha më lartë u vendos si në dispozitive të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NE MITROVICE
C.nr.150/2008 dt 29.04.2014

Gjyqtari,
Ragip Kadriu,

KESHILLE JURIDIKE: Kunder këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankese në
afatin prej 15 ditëve nga dita e pranimit, Gjykates së
Apelit të Kosovës e përmes kesaj gjykate.